

GREEN COAST SH.P.K.

RRUGA "TISH DALJA", KOMPLEKSI KIKA 2, GODINA 3, KATI 1., TIRANE, SHQIPËRI

L41329038D

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 24.03.2023, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë **Green Coast Sh.p.k.** (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

- **Shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, përfaqësuar rregullisht nga Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptar, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. 0342771384 (dhe me nr. Personal: I35203147R), madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (këtu e në vijim referuar si "**Ortaku i Vetëm**"),

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton z Bers Hado, këshilltar ligjor i shoqërisë, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtroi se kapitali aktual i Shoqërisë është 2,053,522,828 LEK (dy miliard e pesëdhjetë e tre milion e pesëqind e njëzetë e dy mijë e tetëqind e njëzetë e tetë lekë).

Me qëllim zhvillimin e projekteve MGallery dhe Green Coast Village ka lindur nevoja e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë. Është vlerësuar e përshtatshme zmadhimi I kapitalit me 1,411,420,500 LEK (një miliard e katërqind e njëmbëdhjetë milion e katërqind e njëzet mijë e pesëqind lekë) të cilat do të shpërndahen përkatësisht sipas projekteve:

477,855,000 LEK (katërqind e shtatëdhjetë e shtatëmilion e tetëqind pesëdhjetë e pesë mijë lek) për projektin MGallery

559,440,000LEK (pesëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e katër qind dyzet mijë lekë) për projektin Green Coast Village_ Nukli L,

94,405,500 LEK (nëntë dhjetë e katër milion e katër qind e pesë mijë e pesëqind lekë) për projektin Green Coast Village Nukli G6B.

128,205,000 LEK (njëqind e njëzet e tëte milion e dyqind e pesë mije lekë) për projektin Green Coast Village Nukli G15

58,275,000 LEK (pesëdhjetë e tetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë lekë) për projektin Green Coast Village Nukli G11

34,965,000 LEK (tridhjetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë lekë) për projektin Green Coast Village Nukli G14

58,275,000 LEK (pesëdhjetë e tetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë lekë) për projektin Green Coast Village Infrastruktura e përbashkët

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

VENDOS:

- A. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë me vlerën 1,411,420,500 LEK (një miliard e katërqind e njëmbëdhjetë milion e katërqind e njëzet mijë e pesëqind lekë), vlerë e cila do të investohen përkatësisht sipas projekteve :**
- vlerën 4.1 milion Euro për projektin MGallery
 - vlerën 4.8 milion Euro për projektin Green Coast Village_ Nukli L
 - vlerën 810,000 Euro për projektin Green Coast Village_ Nukli G6B
 - vlerën 1.1 milion Euro për projektin Green Coast Village_ Nukli G15
 - vlerën 500,000 Euro për projektin Green Coast Village_ Nukli G11
 - vlerën 300,000 Euro për projektin Green Coast Village_ Nukli G14
 - vlerën 500,000 Euro për projektin Green Coast Village_ Infrastruktura e përbashkët
- B. Bazuar në sa më sipër zmadhimi i kapitalit do të konsiderohet Kontribut ne Para nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë dhe i shlyer plotësisht prej tij.**
- C. Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, kapitali i Shoqërisë nga 2,053,522,828 LEK (dy miliard e pesëdhjetë e tre milion e pesëqind e njëzetë e dy mijë e tetëqind e njëzetë e tetë lekë) do të bëhet 3,464,943,328 LEK (tre miliard e katërqind e gjashtëdhjetë e katër milion e nëntëqind e dyzet e tre mijë e treqind e njëzet e tetë lekë) .**

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "Green Coast" sh.p.k mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
GREEN COAST SH.P.K.**

KRYETARI



Znj. Edlira MUKA

SEKRETARI



Z. Bers Hado

